



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr 72 date 26/07/2002

**PER  
DETYRIMET FINANCIARE TE BASHKISE TIRANE NDAJ PERSONAVE  
TE TRETË QE LIDHEN ME VENDIME GJYQESORE TE FORMES SE  
PRERE**

Mbështetur në Nenin 32, gërma g, të Ligjit 8652 dt.31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” dhe në bazë të V.K.B. Nr.4 dt.11.02.2002 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2002 dhe miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2002”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të miratojë listën dhe shumat përkatëse të detyrimeve financiare të Bashkisë Tiranë, që lidhen me detyrime gjyqësore të formës së prerë ndaj personave të tretë, sipas listës bashkëngjitur. Shuma prej 13.399.683 lekë + 12.000 USD, do të përballohet nga fondi i vënë në dispozicion me miratimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike apër zbatimin e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**

